



VENDIM NR. 1

i Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare "Eurokol" Sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 8219 date 24.11.1993, te Gjykates se rrethit Tirane.

Sot me date 11 Shkurt te vitit 1999, u be mbledhja e zakonshme e ortakeve te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k. me kete renditje:

- A. Shqyrtimi i kerkeses se ortakeve, Z. Petrit Mersini dhe Z. Luan Shahu dhe Zj. Natasha Moisiu per t'u larguar nga shoqeria.
- B. Shqyrtimi i propozimit te ortakut Petrit Mersini dhe Luan Shahu per shitjen e kuotave te tyre ne kete shoqeri ortakeve te tjere Zoterinjve Pandi Carapuli dhe Robert Kasneci.
- C. Zvogelimi i kapitalit te shoqerise nga 5000000 (pese milion) ne 1280000 leke (nje milion e dyqind e tetedhjete mije).

Mbledhja u drejtua nga ortaku administrator Z. Petrit Mersini. Ne mbledhje morren pjese te gjithe ortakët te cilet mbasi diskutuan per problemet e caktuara ne rendin e dites, me unanimitet te plote

VENDOSEN


1. Te pranojne kerkesat e ortakeve Petrit Mersini, Luan Shahu dhe Natasha Moisiu per largimin si ortakë nga shoqeria.
2. Zoterinje Pandi Carapuli dhe Robert Kasneci pranojne blerjen e pjese takuese ne shoqeri te Zoterinjve Petrit Mersini dhe Luan Shahu perkundrejt cmimit prej 400000 (katerqind mije) leke secili. Shitja e pjeseve takuese dhe pagimi i cmimit per keto pjese do te behet me kontrata te vecanta.
Petrit Mersini dhe Luan Shahu me kontraten e shitjes Nr.Rep. 2685, Nr. Kol. 7694 kane blere nga Natasha Moisiu pjesen e saj takuese ne kete shoqeri. Prandaj me shitjen e permendur me siper Petrit Mersini dhe Luan Shahu shesin edhe pjesen qe kane fituar nga Natasha Moisiu.
3. Me blerjen e pjeseve te Zoterinjve Petrit Mersini dhe Luan Shahu, Zoterinjte Robert Kasneci dhe Pandi Carapuli mbeten te dy ortakë te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k. ne pjese te barabarta, nga 50% secili.
4. Zonja Natasha Moisiu pjesen e saj takuese ne kete shoqeri ua ka shitur Zoterinjve Petrit Mersini dhe Luan Shahu me ane te kontrates se shitjes se kuotave Nr.Rep. 2685, Nr. Kol. 7694 date 13.11.1997.
5. Zoti Petrit Mersini dhe Zonja Natasha Moisiu largohen si administratore te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k. dhe ne vend te tyre, administratore te kesaj shoqerie do te jene te dy ortakët, Z. Robert Kasneci dhe Z. Pandi Carapuli.
6. Mbas largimit te ortakeve Petrit Mersini, Luan Shahu dhe Natasha Moisiu kapitali themeltar i shoqerise "Eurokol" Sh.p.k. mbetet ne shumen 1280000 leke (nje milion e dyqind e tetedhjete mije). Ky kapital perfaqeson kundravleften e pasurise se palujtshme (Magazinat e Prezes) qe mbas realizimit te shitjes se pjeseve tekuese te Zoterinjve Petrit Mersini dhe Luan Shahu, 4/5 pjese te saj do te mbeten ne kapitalin themeltar te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k.. Ky kapital, qe perfaqeson kundervleren e magazinave ne Preze, eshte vleresuar me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane, Nr. 1523 date 25.01.1977 ne shumen 1600000 (nje milion e

gjashteqind mije). Duke zbritur nga kjo shume 1/5 e vleres se tij, vlera prej 1280000 (nje milion e dyqind e tetedhete mije) leke mbetet ne kapitalin themeltar te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k., ne bashkepronesi te Robert Kasnecit dhe Pandi Carapulit, ne pjese te barabarta.

7. Te ardhurat e grumbulluara nga lehtesite tatimore bazuar ne bilancin e dates 31.12.1998 mbeten ne llogarine e "Eurokol" Sh.p.k. dhe shperndarja e tyre ndermjet ortakeve do te behet ne perfundim te afatit ta caktuar nga Ligji Nr. 7677 date 30.03.1993
8. Deri me date 01.04.1999 shoqeria "Eurokol" Sh.p.k. do te administrohet nga Zoterinjte Petrit Mersini dhe Luan Shahu, (sipas aktmarreshjes midis ortakeve date 01.10.1993). Deri me date 01.04.1999 Zoterinjte Petrit Mersini dhe Luan Shahu do te likujdojne plotesisht detyrimet e shoqerise "Eurokol" Sh.p.k., do te zbresin shumen e kredise qe del nga bilanci i fundit per llogari te organeve fiskale, vlerat monetare (Arke e Banke) dhe vlerat materiale te magazines, dhe keto do ti ndajne ndermijete te dyve nga 50% secili. Ne menyre te barabarte do te ndajne dhe paisjet qe u perkasin atyre. Mbas veprimeve te mesiperme, ortaket e larguar nuk kane asnje te drejte pasurore mbi shoqerine "Eurokol", me perjashtim te te drejtes te parashikuar ne piken 7 te ketij vendimi.
9. Mbas dates 01.04.1999 firma "Eurokol" Sh.p.k. mbetet ne bashkepronesi te plote ne pjese te barabarta te ortakeve Robert Kasneci dhe Pandi Carapuli.
10. Ne qofte se gjate aktivitetit te shoqerise "Eurokol" Sh.p.k del ndonje detyrim i paparashikuar, qe e ka prejardhjen e tij para dates 01.04.1999 per kete detyrim do te mbajne pergjegjesi ne menyre te barabarte Zoterinjte Petrit Mersini dhe Luan Shahu. Edhe kredite qe mund te vijne mbas dates 01.04.1999 po qe i perkasin periudhes para dates 01.04.1999 u takojne Zoterinjve Petrit Mersini dhe Luan Shahu.
11. Me kete vendim te ortakeve ndryshohet neni 1 dhe 5 i kontrates dhe neni 1 dhe 6 i Statutit te Shoqerise.
12. Ky vendim te depozitohet ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane per tu bere shenimet perkatese.

ORTAKET


Luan SHAHU



Petrit MERSINI



Pandi CARAPULI



Robert KASNECI

